



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

RAPORT NGA PROCESI I KONSULTIMIT TË:

PROJEKT - UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) NR. 00/2021 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE PËR VENDOSJEN NË TREG TË PRODUKTEVE PËR IZOLIM TERMIK NË NDËRTEZA - POLISTIRENI I BYMYER

KAPITULLI I

Hyrja/sfondi

Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) respektivisht Departamenti i Industrisë (Divizioni për Infrastrukturë të Cilësisë) në cilësinë e Organit Propozues për hartimin e projekt-Udhëzimit Administrativ (MINT) Nr. 00/2021 për Përcaktimin e Kushteve për Vendosjen në Treg të Produkteve për Izolim Termik në Ndërtesa - Polistireni i Bymyer, ka propozuar hartimin e tij me qëllim që të mundësojë implementimin e mëtutjeshëm të Ligjit Nr.06/L-033 për Produktet e Ndërtimit përkatësisht nenit 50 dhe 55 paragrafët 4-6, implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (Neni 80) “Standardizimi, Metrologjia, Akreditimi dhe Vlerësimi i Konformitetit” pasi që siguron një lehtësimin në zbatimin e politikave për lëvizjen e lirë të mallrave në përputhje me ligjin e BE-së duke rritur informacionin dhe besimin në performancën e deklaruar të produkteve të ndërtimit të vëna në dispozicion të tregut. Me vazhdimin e hartimit të legjislacionit të produkteve të ndërtimit të cilat prodhohen dhe vihen në dispozicion të tregut, Kosova promovon përdorimin e rregullave teknike të BE-së, standardeve të harmonizuara evropiane dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit përkatësisht sistemin për vlerësimin e verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës (AVCP).

Përmes hartimit të këtij akti nënligjor është krijuar baza ligjore e cila përcakton kushtet për vendosjen e polistirenit të bymyer në treg duke mundësuar kështu përmbushjen e kërkesave themelore dhe karakteristikave specifike mandatore të cilat duhet të deklarohen nga prodhuesit. Gjithashtu, ky Projekt-Udhëzim Administrativ përshkruan edhe detyrimin e prodhuesve për shënjinin e produkteve me shenjen e konformitetit “CE” apo shenjen kombëtare të konformitetit si dhe hartimin e deklaratës së performancës e cila duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut. Këto zhvillime do të ndihmojnë në rregullimin e tregut vendor, arrijen e perfaorances së produkteve të ndërtimit dhe përmirësimin e cilësisë së punimeve ndërtimore si dhe do të hapë rrugën për integrimin e Kosovës në tregun e BE-së përmes largimit të barrierave të pajustificuara teknike në tregti dhe fuqizimit të pozitës së saj në tregjet e jashtme.

Bazuar në Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë, Udhëzim Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Ministria i ka kaluar hapat e mëposhtëm të procesit legjislativ si: formimin e grupit punues, pjesëmarrjen në disa takime me grupin punues për hartimin e Projekt - Udhëzim Administrativ (MINT) nr.00/2021 për caktimin e kushteve për vendosjen në treg të polistirenit të bymyer, konsultimin me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në lidhje me përcaktimin e kërkesave rregullatore, pastaj me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës për te vlerësuar kapacitetet teknike të TVKve (Trupave për Vlerësimin e Konformitetit)të akredituara nëse të njëjtit mund të ofrojnë shërbime certifikimi apo testimi si dhe krejt në fund komunikimi me operator ekonomik të këtyre produkteve për t'i njoftuar ata për kërkesat dhe specifikimet teknike të cilat duhet të plotësohet me rastin e prodhimit dhe tregtimit të pllakave për terrace siç përcaktohet në projekt Udhëzimin Administrativ të cilat mbulojnë këto produkte.

Qëllimi dhe fushëveprimi i konsultimit gjatë hartimit të politikave është me rëndësi që të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e konsultimit të jenë të njohur qysh prej fillimit me qëllimin dhe fushëveprimin e këtij Projekt - Udhëzimi Administrativ. Kjo i ka ndihmuar Ministrinë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) për të analizuar gjendjen, identifikimin e problemeve, opsioneve, përgatitjen e rekomandimeve dhe propozimeve nga palët e interesit, për finalizimin e akteve nënligjore të lartcekura.

Ecuria e procesit të konsultimit

Duke pasur parasysh se procesi i konsultimeve është realizuar dhe është zhvilluar konform rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Punën e Qeverisë nr. 09/2011, Rregulloren Nr. 05/2016 Për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, Udhëzuesin për procesin e konsultimeve Nr.062/2011 dt. 26.09.2011, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), si organ propozues i këtij akti nënligjor ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike në të cilën periudhë e ka dërguar në Konsultim tek të gjitha institucionet përkatëse dhe shoqatat relevante, që t'ju ofrojë informata për publikun e në veçanti për grupet e interesit me qëllim të merret mendimi i publikut dhe grupeve të interesit rreth hartimit të këtij Projekt - Udhëzimi Administrativ.

*Gjatë kësaj periudhe lidhur me këtë Projekt – Udhëzimi Administrativ **nuk kemi pranuar komente nga palët e interesit në lidhje me materien, përmbajtjen, detyrimet e palëve të cilat do të përfshihen në zbatimin e këtyre dispozitave.***

Kohëzgjatja e procesit të konsultimit të dokumentit në fjalë, është bërë konform Rregulloreve për Punën e Qeverisë nr. 09/2011.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i pjesëmarrësve të cilët kanë kontribuar	Numri i komenteve të pranuar	Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i pjesëmarrësve të cilët kanë kontribuar	Numri i komenteve të pranuar
1. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike ;	Data e fillimit: 15.09.2021 Data e përfundimit 06.10.2021 15 ditë pune	38	0	0	2. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike;				
3. Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike					4. Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike				
5. Takimet publike					6. Takimet publike				
7. Konferencat					8. Konferencat				
9. Takime me grupe të interesit					10. Takime me grupe të interesit				
11. Punëtoritë	Dt.11.06.2021	10	10	Diskutim për draft-UA	12. Punëtoritë				
13. Intervistat/takimet synë sy					14. Intervistat/takimet synë sy				
15. Hulumtime të opinionit					16. Hulumtimet e opinionit				
17. Votimi diskutues					18. Votimi diskutues				
19. Panelet me qytetarë					20. Panelet me qytetarë				
21. Stendat në rrugë					22. Stendat në rrugë				
23. tjetër					24. tjetër				

Përmbledhje e kontributeve të pranura gjatë procesit të konsultimit dhe kategoritë e kontribuesve

Nuk ka pasur.

Hapat e ardhshëm

Tabela e detajuar me informatat për kontribuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranura dhe të refuzuara.

Emri i organizatës /individit	Koment i organizatës /individit	Përgjigja nga Ministria E pranuar plotësisht E pranuar pjesërisht E refuzuar	Sqarim nga Ministria (veçanërisht arsyet për të mos pranuar komente të caktuara)